



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2324 Prot.

Shkodër, më 19.06. 2026

V E N D I M

Nr. 188, datë 19.06 2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT TË ADMINISTRATORIT NR.75 DATË 18.06.2026
"PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VERIFIKIMIN TEKNIK, JURIDIK, TË
PROKURIMIT DHE FINANCIAR TË DOKUMENTACIONIT TË
KONTRATËS NR.1391/11, DATË 12.07.2021 TË LIDHUR ME SHOQËRINË "PC
STORE"**

Në mbështetje të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, nenet 109, pika 1, gërmat ç) dhe d), 113 dhe 116; Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 47; Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 124 dhe 127; VKM-në nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 107; pasi u njohëm me aktin objekt i kërkesës për shfuqizim, si dhe përmbajtjen e argumentet e dhëna në shkresat 2263/3 prot, 2263/2 prot dhe 2263/1 prot datë 18.06.2026, konstatohet se ky urdhër është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, si dhe në kundërshtim me ligjin material. Për këtë arsye, Bordi i Administrimit, në mbledhjen online të datës 19.06.2026 me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e Urdhrit të Administratorit nr.75, datë 18.06.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin teknik, juridik, të Prokurimit dhe Financiar të dokumentacionit të kontratës nr.1391/11, datë 12.07.2021 të lidhur me shoqërinë "PC Store".
2. E drejta dhe kompetenca e Administratorit për verifikim dhe zbatim të ligjshmërisë në procedurat e prokurimeve publike, zbatohet vetëm për procedurat e prokurimeve të iniciuara në kohën e emërimit të tij, si dhe për ato që janë në zbatim e sipër, për fazën konkrete ku ndodhen, në përputhje me legjislacionin e fushës së prokurimeve.
3. Ngarkohen Administratori për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit
Prof. Asoc. Dr. Adrian Leka

